



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kms hc.al



www.kms hc.al

16 Janar 2025

NJOFTIM

PËR MARRJEN E MASAVE NË KUADËR TË PROCESIT TË MBIQËQYRJES SË ZBATIMIT TË LEGJISLACIONIT PËR NËPUNËSIN CIVIL GJATË PERIUDHËS ZGJEDHORE

Komisioneri për Mbiqëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet Urdhrit nr. 9, datë 14.01.2025, "Për krijimin e grupit të gatshëm dhe organizimin e procesit të monitorimit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil me objekt veprimtarie: emërimet e reja dhe sjellja e nëpunësve civilë gjatë procesit zgjedhor", ka nisur një proces monitorimi, i cili do të vlerësojë zbatimin e ligjit për nëpunësin civil dhe sjelljen e nëpunësve civilë gjatë procesit të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë, që zhvillohen në datën 11 maj 2025.

Duke marrë parasysh problematikën e evidentuar gjatë procesit të monitorimit në zgjedhjet e mëparshme, me qëllim që zbatimi i ligjit për nëpunësin civil të jetë në koherencë të plotë me rregullimet e Kodit Zgjedhor, që lidhen me periudhën specifike të zgjedhjeve, Komisioneri vlerësoi se është e nevojshme që të udhëzohen institucionet që përfshihen në sistemin e shërbimit civil për të unifikuar praktikën në lidhje me: a) ecurinë e procesit të rekrutimit gjatë kësaj periudhe; b) pjesëmarrjen e nëpunësve civilë, në institucionet e krijuara për të administruar procesin zgjedhor; c) respektimin e të drejtave politike të nëpunësve civilë; d) ndërveprimi i nëpunësit civil me mediat sociale, për të shmangur propagandën elektorale dhe e) masat që do të merren nga institucionet për të vendosur kontrollin mbi sjelljen e nëpunësve civilë të institucionit.

Për këtë arsye, Komisioneri miratoi Udhëzuesin nr. 15, datë 15.01.2025, "Për unifikimin e zbatimit të ligjit për nëpunësin civil në drejtim të zhvillimit të procesit të rekrutimit gjatë periudhës zgjedhore; pjesëmarrjes së nëpunësve civilë në institucionet e administrimit të procesit zgjedhor; respektimit të të drejtave të tyre politike e detyrimeve ligjore; ndërveprimin e nëpunësve civilë me "Platformat" apo "Rrjetet sociale" që shfaqen për publikun nëpërmjet internetit, për të shmangur propagandën elektorale; si dhe masat që duhet të marrin institucionet për të monitoruar situatën.", si dhe aktet që do të materializojnë këtë proces nga ana e institucioneve, siç janë urdhri për ngritjen e grupit të monitorimit, rregullorja e grupit të monitorimit dhe akti i konstatimit të prezencës në punë, të cilat u janë dërguar të gjitha institucioneve që bëjnë pjesë në shërbimin civil, si dhe janë publikuar në faqen kryesore të internetit të Komisionerit, www.kms hc.al.